

V E N D I M
Nr. 62, datë 23.1.2003

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 402, DATË 11.6.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 7703, DATË 11.5.1993
“PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” DHE LIGJIT NR.
7870, DATË 13.10.1994 “PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË””, NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR. 458, DATË 28.6.2001 TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 402, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, të bëhet ky ndryshim:

Paragrafi i parë i pikës 6, të kapitullit III, të ndryshohet si më poshtë vijon:

“Të vetëpunësuarit në bujqësi derdhin kontribut vjetor për sigurimet shoqërore në masën 5 215 (pesë mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë) lekë, me përjashtim të atyre që jetojnë në rrethet: Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë dhe Tropojë, për të cilët masa e kontributit vjetor të jetë 3 592 (tre mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2003.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano